



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 5655 prot.

Shkodër, më 7 3. 2025

**VENDIM**

**Nr. 18, datë 03.03.2025**

**“PËR MIRATIMIN E SHKËMBIMIT TË PASURIVE MIDIS BASHKISË  
SHKODËR DHE MINISTRISË SË BRENDSHME”.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 03.03.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1.2, nenit 54 pika e/1, të ligjit Nr. 139, datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 Kodi Civil i RSH; VKM Nr. 393, datë 19.6.2024” Për transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Shkodër,të pronës me emërtimin “Agjencia Rrenc”, me vendndodhje në Rrenc, Shkodër,VKM Nr.250, datë 20.04.2010, “Për transferimin e pronave Ministrisë”, VKM Nr.500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësite e qeverisjes vendore” ,të ndryshuar; Udhëzimit Nr.15, datë 30.06.2003 “Për menyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”,si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

**VENDOSI :**

1. Të miratojë heqjen nga inventari i pronave të Bashkisë Shkodër të një pjesë të pasurisë Nr.19/2 ZK 3168 ,si më poshtë:

- *Sipërfaqen prej 23149m<sup>2</sup> një pjesë e pasurisë totale me nr.19/2 ZK 3168 e transferuar me VKM nr. 393, datë 19.6.2024 "Për transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Shkodër, me vendndodhje në Rrenc, Shkodër sipas plan riveimit bashkëlidhur.*
2. Miratimin e shkëmbimit të një pjesë të pasurisë me Nr.19/2 ZK 3168 me sipërfaqe 23149 m<sup>2</sup> në pronësi të Bashkisë Shkodër, në favor të Ministrisë së Brendshme.
  3. Miratimin e shkëmbimit të pasurisë me Nr.10/127 sipërfaqe trualli si dhe ndërtesave me truallin funksional të tyre me numra pasurie: Nr.10/128, Nr.10/129, Nr.10/130, Nr.10/131, Nr.10/132, Nr.10/133 dhe Nr.10/134 nga Ministria e Brendshme, në favor të Bashkisë Shkodër.
  4. Fusha e përdorimit për këtë pasuri të që do të kalojë në favor të Bashkisë Shkodër, do të jetë *prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve social-kulturore e sportive.*
  5. Të ndiqen procedurat përkatëse sipas legjislacionin në fuqi, pas miratimit nga Këshilli Bashkiak Shkodër për ndryshimin e pronësisë të pasurive të sipërcituar duke bashkërenduar punën me Ministrinë dhe Institucionet përgjegjëse.
  6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
  7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Miratuar me 31 vota

Vota Pro	31
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	1
Zbardhur me datë	04.03.2025

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**



**KRYETAR**

**Oltion LULI**

